





MAINTENANCE MANUAL



INSTANDHALTUNGSANLEITUNG

MANUEL D'ENTRETIEN

ISTRUZIONI PER LA MANUTENZIONE



972.169.00.0(00)



Rreth këtij dokumenti

Ky dokument vlen për mirëmbajtjen profesionale të produkteve të mëposhtme:

- Rubineti për lavaman Geberit Piave, me montim vertikal dhe në mur
- Rubineti për lavaman Geberit Brenta, me montim vertikal dhe në mur

Ky dokument vlen për realizimin e këtyre rubinetave për lavaman me ndërfaqen e lidhjes Bluetooth®. Këta rubineta për lavaman janë të shënuar me shprehjen "IWT-17-A" dhe me logon Geberit Connect në etiketën e tipit.

Grupi i synuar

Ky produkt lejohet të mirëmbahet dhe riparohet vetëm nga punonjës të specializuar. Një punonjës i specializuar është një person, i cili për shkak të shkollimit, trajnimit dhe/ose përvojës së tij është i aftë të dallojë evitohet rreziqet që shfaqen gjatë përdorimit të produktit.

Përdorimi i parashikuar

Rubinetat për lavaman Geberit Piave dhe Brenta janë parashikuar për marrjen e ujit nga linja. Çdo përdorim tjetër konsiderohet si jo në përputhje me përdorimin e parashikuar. Geberit nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për pasojat nga përdorimi jo në përputhje me përdorimin e parashikuar.

Shpjegimi për udhëzimet paralajmëruese

Udhëzimet paralajmëruese janë vendosur në vendin ku mund të ndodhë rreziku.

Udhëzimet paralajmëruese janë të ndërtuara si më poshtë:



PARALAJMËRIM

Lloji dhe burimi i rrezikut

Pasojat e mundshme në rastin e mospërfilljes së rrezikut.

- Marrja e masave për shmangien e rrezikut.

Fjalët e mëposhtme sinjalizuese përdoren, për të treguar në udhëzimet paralajmëruese për rreziqet e mbetura dhe për të treguar informacionet e rëndësishme.


Simboli	Fjala sinjalizuese dhe kuptimi
	VINI RE Fjala sinjalizuese tregon një rrezik me një shkallë të ulët rreziku, i cili nëse nuk shmanget, mund të ketë si pasojë lëndime të papërfillshme ose të lehta.
	Të shënuara vetëm me simbol. Tërheq vëmendjen mbi një informacion të rëndësishëm

Udhëzimet e sigurisë

Punimet e mirëmbajtjes ose riparimet e papërshtatshme mund të çojnë në dëmtime ose defekte në funksionim.

- Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale për riparimet.
- Mos bëni ndryshime ose instalime shtesë në produkt.


Ndërtimi i rubinetit vertikal



Ilustrimi 1: Rubinetat për lavaman Geberit Piave dhe Brenta, me montim vertikal

- 1 Trupi i rubinetit me tubin mbrojtës
- 2 Rregullatori i rrjedhës
- 3 Sensori me rreze infra të kuqe
- 4 Pllaka mbuluese ose kapaku
- 5 Ushqimi elektrik (ushqyes elektrik, fole baterish ose akumulator për funksionimin me gjenerator)
- 6 Sistemi elektronik i komandimit
- 7 Filtri me kosh
- 8 Mishelatori
- 9 Mishelatori me termostat
- 10 Blloku funksional
- 11 Elektrovalvula
- 12 Njësitë mbyllëse

Ndërtimi i rubinetit në mur



Ilustrimi 2: Rubinetat për lavaman Geberit Piave dhe Brenta, me montim në mur

- 1 Trupi i rubinetit
- 2 Rregullatori i rrjedhës
- 3 Sensori me rreze infra të kuqe
- 4 Pllaka mbuluese
- 5 Ushqimi elektrik (ushqyes elektrik, fole baterish ose akumulator për funksionimin me gjenerator)
- 6 Sistemi elektronik i komandimit
- 7 Filtri me kosh
- 8 Mishelatori
- 9 Mishelatori me termostat
- 10 Blloku funksional
- 11 Elektrovalvula
- 12 Njësitë mbyllëse

Të dhënat teknike

Të dhënat teknike të mëposhtme vlejné për rubinetat për lavaman Geberit Piave dhe Brenta, me montim vertikal dhe montim në mur.

	Funksionimi elektrik	Funksionimi me bateri ¹⁾	Funksionimi me gjenerator ²⁾
Tensioni nominal	110–240 V AC	—	—
Frekuenca e rrjetit	50–60 Hz	—	—
Tensioni i punës	4,5 V DC	3 V DC	3,2 V DC
Tipi i baterisë	—	Alkali (1,5 V AA)	—
Konsumi i energjisë	0,1 W	—	—
Presioni i punës	0,5–10 bar	0,5–10 bar	2–10 bar
Presioni i rekomanduar i punës me mishelator me termostat	0,5–5 bar	0,5–5 bar	—
Temperatura e ambientit	1–40 °C	1–40 °C	1–40 °C
Temperatura e ruajtjes	-20 – +70 °C	-20 – +70 °C	-20 – +70 °C
Temperatura maksimale e ujit	60 °C	60 °C	60 °C
Temperatura maksimale e ujit, afatshkurtër	90 °C	90 °C	90 °C
Diapazoni i caktimit të temperaturës së ujit me mishelator me termostat	20–42 °C	20–42 °C	—
Shpejtësia e qarkullimit në 3 bar ³⁾	5 l/min	5 l/min	5 l/min
Teknologjia me valë	Bluetooth® Low Energy ⁴⁾		
Diapazoni i frekuencave	2400–2483,5 MHz		
Fuqia maksimale në dalje	4 dBm		

— Nuk përshtatet

¹⁾ Jetëgjatësia e baterisë arrin për rreth 200 000 aktivizime.

²⁾ Nga mesatarisht 50 përdorime në ditë me një kohëzgjatje prej 4 s secila, rubineti i lavamanit funksionon në mënyrë të pavarur.

³⁾ Rregullatorët e rrjedhës me kufizues qarkullimi prej 1,3 l/min, 1,9 l/min ose 3,8 l/min ofrohen si aksesore.

⁴⁾ Marka Bluetooth® dhe logot e saj janë pronë e Bluetooth SIG, Inc. dhe përdoren nga Geberit me licencë.

Deklarata BE e konformitetit, versioni i thjeshtë

Me anë të kësaj deklarate, Geberit International AG deklaron që pajisja radio e tipit Rubinet për lavaman Geberit Piave dhe Brenta me funksionim elektrik, funksionim me bateri ose funksionim me gjenerator, është në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.

Teksti i plotë i deklaratës BE të konformitetit gjendet në adresën e mëposhtme të internetit:

<https://doc.geberit.com/970895000.pdf>

Përdorimi

Aplikacionet Geberit

Për përdorimin, kryerjen e rregullimeve dhe për mirëmbajtjen ekzistojnë aplikacione të ndryshme nga Geberit. Aplikacionet komunikojnë me pajisjen nëpërmjet ndërfaqjes së lidhjes Bluetooth®.

Aplikacionet Geberit mund të shkarkohen falas për smartfonët Android dhe iOS në dyqanin përkatës të aplikacioneve.

Vendosja e lidhjes me pajisjen

- Skanoni kodin QR dhe ndiqni instruksionet në faqen kryesore.

Geberit
Apps



<https://gbrt.io/dsvFD0E>

Eliminimi i defekteve

Veprimet e mëposhtme për eliminimin e defekteve mund të kryhen nga vetë operatori:

- Pastrimi i rregullatorit të rrjedhës
- Pastrimi i filtrit me kosh
- Ndërrimi i baterive
- Karikimi i baterisë për funksionimin me gjenerator

Këto veprime janë përshkruar në manualin e operimit 970.664.00.0.

Defekti	Shkaku	Eliminimi
Rryma e ujit shumë e dobët	Rregullatori i rrjedhës është pis	► Pastroni rregullatorin e rrjedhës. → Shihni manualin e operimit 970.664.00.0.
	Filtri me kosh i bllokuar	► Pastroni filtrin me kosh. → Shihni manualin e operimit 970.664.00.0.
	Presioni i linjës është shumë i dobët	► Kontrolloni presionin e linjës (0,5–10 bar).
Shpëlarja nuk aktivizohet	Presioni i linjës është shumë i dobët	► Kontrolloni presionin e linjës (0,5–10 bar).
	Ndërprerje e rrjetit	► Kontrolloni ushqimin elektrik.
	Bateritë të konsumuara ose akumulatori bosh	► Ndërroni bateritë ose karikoni akumulatorin e funksionimit me gjenerator. → Shihni manualin e operimit 970.664.00.0.
	Rubineti për lavaman është në modalitetin e pastrimit (pulson LED i kuq)	► Pritni rreth 2 minuta.
	Distanca e zbulimit është vendosur gabim	► Optimizoni distancën e zbulimit.
	Reflektime interferuese nga lavamani	► Optimizoni distancën e zbulimit.
	Elektrovalvula me defekt	► Ndërroni elektrovalvulën. → Shihni "Ndërrimi i elektrovalvulës", faqja 14.
	Sensori me rreze infra të kuqe me defekt	► Ndërroni sensorin me rreze infra të kuqe.
	Sistemi elektronik i komandimit me defekt	► Rindizni sistemin elektronik të komandimit. → Shihni . ► Ndërroni sistemin elektronik të komandimit.
Uji rrjedh pa ndërprerje	Objekte ndërhyrëse në zonën e zbulimit	► Largoni objektet nga zona e zbulimit.
	Elektrovalvula me defekt	► Ndërroni elektrovalvulën. → Shihni "Ndërrimi i elektrovalvulës", faqja 14.
	Sensori me rreze infra të kuqe me defekt	► Ndërroni sensorin me rreze infra të kuqe.
	Presioni i linjës shumë i lartë	► Kontrolloni presionin e linjës (0,5–10 bar).
	Sistemi elektronik i komandimit me defekt	► Rindizni sistemin elektronik të komandimit. → Shihni . ► Ndërroni sistemin elektronik të komandimit.

Defekti	Shkaku	Eliminimi
Uji rrjedh në mënyrë të panevojshme, shumë shpejt ose shumë vonë	Dritarja e rrezeve infrakuqe e ndotur ose e lagur	► Pastroni ose thani dritaren e rrezeve infrakuqe.
	Dritarja e rrezeve infrakuqe e krisur	► Ndërroni sensorin me rreze infra të kuqe.
	Distanca e zbulimit e sensorit me rreze infra të kuqe është vendosur gabim	► Optimizoni distancën e zbulimit.
	Sensori me rreze infra të kuqe ka ndërhyrje nga ndikimet e ambientit (pasqyrë, sipërfaqe metalike, lavaman xhami etj.)	► Rindizni sistemin elektronik të komandimit. → Shihni . ► Kalibroni përsëri sensorin me rreze infra të kuqe. → Shihni .
	Luhatjet e presionit në rrjetin e ujit	► Instaloni një rregullator presioni të përshtatshëm.
Nga trupi i rubinetit rrjedh ujë	Rruga e kalimit të ujit jo hermetike	► Kontrolloni rrugën e kalimit të ujit. ► Ndërroni tubin e lidhjes dhe guarnicionet.
	Elektrovalvula nuk mbyllet si duhet	► Pastroni ose ndërroni elektrovalvulën. → Shihni "Ndërimi i elektrovalvulës", faqja 14.
Temperatura e ujit nuk mund të rregullohet (vetëm rubinetat për lavaman me mishelator ose mishelator me termostatat)	Filtri me kosh është pis	► Pastroni filtrin me kosh. → Shihni manualin e operimit 970.664.00.0.
	Diferencë presioni midis linjës së ujit të ftohtë dhe të ngrohtë më e madhe se 1,5 bar	► Rregulloni diferencën e presionit. ► Montoni një kufizues qarkullimi ose një valvul reduktuese të presionit.
	Temperatura e ujit shumë e ulët ose shumë e lartë	► Kontrolloni temperaturën e ujit.
Temperatura e ujit nuk është konstante (vetëm rubinetat për lavaman me mishelator me termostatat)	Mishelatori me termostatat me defekt	► Ndërroni bllokun e funksionimit të mishelatorit me termostatat. → Shihni "Ndërimi i bllokut funksional", faqja 11.
Temperatura e ujit është > 42°C (vetëm rubinetat për lavaman me mishelator me termostatat)	Kufizuesi i temperaturës në mishelatorin me termostatat është çaktivizuar, për shembull gjatë dezinfektimit termik	► Aktivizoni përsëri kufizuesin e temperaturës. → Shihni "Kryerja e dezinfektimit termik", faqja 10.
	Mishelatori me termostatat me defekt	► Ndërroni bllokun e funksionimit të mishelatorit me termostatat. → Shihni "Ndërimi i bllokut funksional", faqja 11.
LED i kuq pulson gjatë aktivizimit të shpëlarjes	Bateritë konsumohen shpejt ose akumulatori shkarkohet shpejt	► Ndërroni bateritë ose karikoni akumulatorin e funksionimit me gjenerator. → Shihni manualin e operimit 970.664.00.0.

Mirëmbajtja nga operatori

Punimet e mëposhtme të mirëmbajtjes mund të kryhen nga vetë operatori. → Shihni manualin e operimit 970.664.00.0.

- Aktivizimi i modalitetit të pastrimit me aplikacionin Geberit
- Aktivizimi i shpëlarjes së vazhdueshme me aplikacionin Geberit
- Pastrimi i trupit të rubinetit
- Pastrimi i rregullatorit të rrjedhës
- Rregullimi i temperaturës së ujit
- Pastrimi i filtrit me kosh
- Ndërrimi i baterive
- Karikimi i baterisë për funksionimin me gjenerator

Mirëmbajtja nga tekniku specialist

Punimet e mirëmbajtjes në kapitujt në vijim lejohen të kryhen vetëm nga një teknik specialist.

Kryerja e dezinfektimit termik

Në rast ngarkimi të instalimeve të ujit të pijshëm nga mikroorganizmat, mund të jetë e nevojshme që të bëni dezinfektim termik të instalimeve të ujit të pijshëm. Nga kjo, si rezultat i ndikimit të temperaturës do të vriten mikroorganizmat që ndodhen në ujë.

Rubinetat për lavaman Geberit Piave dhe Brenta me mishelator me termostad kanë një mbrojtje kundër djegies. Për këtë qëllim, temperatura e ujit kufizohet në 42°C. Për dezinfektimin termik duhet që kufizimi i temperaturës së mishelatorit me termostad të çaktivizohet, me qëllim që temperatura e ujit të mund të rritet.

Kur bëhet dezinfektimi termik duhet që në të gjitha pikat e marrjes të rrjedhë ujë i nxehtë 70°C për të paktën 3 minuta.


1

Hiqni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **1**, faqja 45.

2

Çaktivizoni kufizimin e temperaturës.

Ngjishni brenda sustën me një kaçavidë dhe hapni plotësisht dorezën.



✓ Ngjyra në dritaren e kontrollit ndryshohet në ngjyrë të kuqe.

3

Nxehni ngrohësin e ujit të pijshëm në të paktën 70°C.



VINI RE

Rrezik djegieje

Djegje nga uji i nxehtë

- Mos i mbani duart poshtë rubinetit të lavamanit.

4

Hapni elektrovalvulën me ndihmën e Geberit Service-Handy. → Shihni "Rregullimet me Geberit Service-Handy", faqja 33, pika 20 e menysë.


5

Sigurohuni që gjatë të paktën 3 minutave të rrjedhë ujë i nxehtë 70°C. Bëni kontrollin me termometër.

6


Mbyllni elektrovalvulën.

- 7** Aktivizoni përsëri kufizuesin e temperaturës. Mbyllni dorezën dhe vendosni temperaturën që dëshironi (20–42 °C).



✓ Ngjyra në dritaren e kontrollit kthehet në ngjyrë blu.


- 8** Kontrolloni temperaturën e ujit.





- 9** Montoni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **4**, faqja 49.

Ndërrimi i bllokut funksional



- 1** Hiqni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **1**, faqja 45.
- 2** Mbyllni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd. → Shihni sekuencën e ilustrimit **2**, faqja 47.
- 3** Aktivizoni një shpëlarje për shkarkimin e presionit.
- 4** Çmontoni sistemin elektronik të komandimit.
- 5** Shkëputni të gjitha kabllot.
- 6** Lironi kabllon e ushqimit elektrik nga mbajtësja dhe çmontoni ushqyesin elektrik, folenë e baterive ose akumulatorin.



7 Çmontoni dhe hidhni bllokun e funksionimit.




8 Hiqni kapakët mbrojtës dhe lyeni me graso guarnicionet unazore.








Kontrolloni rakordin përshtatës të tubit.



Nëse përdoret një bllok funksional pa mishelator me termostatat, mund të përdoret rakordi përshtatës i tubit me një pjesë ose me dy pjesë.









Nëse përdoret një bllok funksional me mishelator me termostatat, duhet përdorur rakordi përshtatës i tubit me dy pjesë (numri i artikullit 244.632.00.1). Ndërroni rakordin përshtatës të tubit, nëse nevojitet. Hiqni pjesën e përparme të rakordit përshtatës të tubit.




9

Montoni bllokun e ri funksional.




- 10** Montoni ushqyesin elektrik, folenë e baterive ose akumulatorin dhe kapni në mbajtëse kabllon e ushqimit elektrik.







- 11** Lidhni kabllon në sistemin elektronik të komandimit. → Shihni sekuencën e ilustrimit **3**, faqja 48.
- 12** Montoni sistemin elektronik të komandimit.
- 13** Hapni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd.
- 14** Kontrolloni funksionimin e rubinetit.
- 15** Vendosni temperaturën e ujit. → Shihni manualin e operimit 967.455.00.0.
- 16** Montoni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **4**, faqja 49.

Ndërrimi i elektrovalvulës





- 1** Hiqni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **1**, faqja 45.
- 2** Mbyllni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd. → Shihni sekuencën e ilustrimit **2**, faqja 47.
- 3** Aktivizoni një shpëlarje për shkarkimin e presionit.
- 4** Çmontoni sistemin elektronik të komandimit.
- 5** Shkëputni të gjitha kabllot.
- 6** Lironi kabllon e ushqimit elektrik nga mbajtësja dhe çmontoni ushqyesin elektrik, folenë e baterive ose akumulatorin.





7 Çmontoni bllokun funksional.









8 Çmontoni dhe hidhni elektrovalvulën.




9 Montoni elektrovalvulën e re.



10 Montoni bllokun funksional.



- 11** Montoni ushqyesin elektrik, folenë e baterive ose akumulatorin dhe kapni në mbajtëse kabllon e ushqimit elektrik.



- 12** Lidhni kabllon në sistemin elektronik të komandimit. → Shihni sekuencën e ilustrimit **3**, faqja 48.

- 13** Montoni sistemin elektronik të komandimit.




- 14** Hapni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd.

- 15** Kontrolloni funksionimin e rubinetit.


- 16** Montoni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **4**, faqja 49.

Ndërrimi i sensorit me rreze infra të kuqe i rubinetit vertikal


- 1** Hiqni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **1**, faqja 45.
- 2** Mbyllni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd. → Shihni sekuencën e ilustrimit **2**, faqja 47.
- 3** Aktivizoni një shpëlarje për shkarkimin e presionit.
- 4** Çmontoni sistemin elektronik të komandimit.
- 5** Shkëputni të gjitha kabllot.
- 6** Lironi vidat e mbajtëses së tubit dhe çmontoni mbajtësen e tubit.




7 Çmontoni tubin mbrojtës.




8 Zhvidhosni dadon e gjatë.




9 Çmontoni mbajtësen e rubinetit.




10 Hiqni rubinetin me tubin mbrojtës nga lavamani.




11 Lironi tapën e poshtme.





12 Hiqni tapën e sipërme.




13 Nxirrni kabllon e sensorit nga tubi mbrojtës.




14 Lironi mbajtësen e sensorit.




15 Nxirrni jashtë pjesën e poshtme të mbajtëses së sensorit dhe shtyni për poshtë sensorin me rreze infra të kuqe.




- 16** Nxirrni nga poshtë mbajtësen e sensorit dhe hidhni sensorin.





- 17** Futni sensorin e ri në mbajtësen e sensorit dhe vendoseni në rubinet.




- 18** Vendosni sensorin me rreze infra të kuqe në dritare dhe mblidhni bashkë mbajtësen e sensorit.




- 19** Mbërtheni me vida mbajtësen e sensorit.




- 20** Kontrolloni vendosjen e sensorit me rreze infra të kuqe në dritaren e sensorit.




- 21** Hiqni filmin mbrojtës.




- 22** Futni kabllon e sensorit në tubin mbrojtës. Shikoni me kujdes kalimin përmes tapës së poshtme.




- 23** Vendosni tapën e sipërme.




24 Vidhosni tapën e poshtme.




25 Vendosni rubinetin mbi lavaman.




26 Futni nga poshtë mbajtësen e rubinetit.




27 Vidhosni mbajtësen e rubinetit me dadon e gjatë.





28 Futni nipelsin e tubit.



29 Lidhni tubin e lidhjes.



30 Fiksoni tubin mbrojtës me mbajtësen.



31 Lidhni kabllon në sistemin elektronik të komandimit. → Shihni sekuencën e ilustrimit **3**, faqja 48.

32 Montoni sistemin elektronik të komandimit.


33 Hapni të dyja njësitetë mbyllëse ose valvulat me kënd.

34 Kontrolloni funksionimin e rubinetit.


35 Montoni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **4**, faqja 49.

Ndërrimi i sensorit me rreze infra të kuqe i rubinetit në mur


- 1** Hiqni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **1**, faqja 45.
- 2** Mbyllni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd. → Shihni sekuencën e ilustrimit **2**, faqja 47.
- 3** Aktivizoni një shpëlarje për shkarkimin e presionit.
- 4** Çmontoni sistemin elektronik të komandimit.
- 5** Shkëputni të gjitha kabllot.
- 6** Lironi vidën e mbërthimit të rubinetit.




- 7** Hiqni rubinetin.




- 8** Nxirrni jashtë kabllon e sensorit dhe hidhni sensorin.




9 Futni kabllon e sensorit të sensorit të ri.




10 Kapni sensorin në mbajtësen e rubinetit.



11 Montoni rubinetin.



12 Vidhosni rubinetin.



13 Lidhni kabllon në sistemin elektronik të komandimit. → Shihni sekuencën e ilustrimit 3, faqja 48.

14 Montoni sistemin elektronik të komandimit.

15 Hapni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd.

16 Kontrolloni funksionimin e rubinetit.

17 Montoni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit 4, faqja 49.

Ndërrimi i tubit të lidhjes së rubinetit vertikal

Tubi i lidhjes së rubinetit vertikal duhet ndërruar vetëm kur ka arsye të detyrueshme, si për shembull ndotje e linjave të furnizimit. Ndërrimi i tubit të lidhjes përshkruhet në manualin e montimit 967.768.00.0.



Për ndërrimin e tubit të lidhjes kontaktoni me një teknik të kompanisë përkatëse të autorizuar të shitjeve të Geberit.

Ndërrimi i tubit të lidhjes së rubinetit në mur

Tubi i lidhjes së rubinetit në mur duhet ndërruar vetëm kur ka arsye të detyrueshme, si për shembull ndotje e linjave të furnizimit.




Për ndërrimin e tubit të lidhjes kontaktoni me një teknik të kompanisë përkatëse të autorizuar të shitjeve të Geberit.

Çmontimi i tubit të lidhjes së rubinetit në mur



- 1** Hiqni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **1**, faqja 45.
- 2** Mbyllni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd. → Shihni sekuencën e ilustrimit **2**, faqja 47.
- 3** Aktivizoni një shpëlarje për shkarkimin e presionit.
- 4** Çmontoni sistemin elektronik të komandimit.
- 5** Shkëputni të gjitha kabllot.

6


Lironi kabllon e ushqimit elektrik nga mbajtësja dhe çmontoni ushqyesin elektrik, folenë e baterive ose akumulatorin.




7 Çmontoni bllokun funksional.




8 Lironi profilin e lidhjes nga mbajtësja e tubit.




9 Çmontoni kunjin e sigurisë dhe shkëputni profilin e lidhjes nga tubi i lidhjes.




10 Lironi vidën e fiksimit.




11 Hiqni rubinetin.




12 Nxirni jashtë kabllon e sensorit dhe hidhni sensorin.




13 Lironi vidat e mbajtëses së rubinetit.




PH 2




14 Çmontoni mbajtësen e rubinetit.




15 Lironi mbajtësen e tubit.



T 10




16 Tërhiqni jashtë tubin e lidhjes nga lart.




Montimi i tubit të lidhjes së rubinetit në mur

- 1** Futni brenda nga lart tubin e ri të lidhjes.




- 2** Tërhiqni jashtë tubin e lidhjes poshtë.




- 3** Hiqni kapakun mbrojtës.




- 4** Lidhni profilin e lidhjes me tubin e lidhjes dhe vendosni kunjjin e sigurisë.




- 5** Kapni profilin e lidhjes në mbajtësen e tubit dhe shtrini tubin e lidhjes në udhëzuesin e tubit.




- 6** Vendosni mbajtësen e tubit me tubin e lidhjes.




7 Mbërtheni me vida mbajtësen e tubit.




8 Montoni mbajtësen e rubinetit.




9 Mbërtheni me vida mbajtësen e rubinetit.





10 Futni kabllon e sensorit të sensorit të ri.









11 Montoni rubinetin.




12 Vidhosni rubinetin.



13 Montoni bllokun funksional.



- 14** Montoni ushqyesin elektrik, folenë e baterive ose akumulatorin dhe kapni në mbajtëse kabllon e ushqimit elektrik.



- 15** Lidhni kabllon në sistemin elektronik të komandimit. → Shihni sekuencën e ilustrimit **3**, faqja 48.

- 16** Montoni sistemin elektronik të komandimit.

- 17** Hapni të dyja njësitë mbyllëse ose valvulat me kënd.

- 18** Kontrolloni funksionimin e rubinetit.

- 19** Montoni pllakën mbuluese. → Shihni sekuencën e ilustrimit **4**, faqja 49.

Kryerja e rregullimeve

Këto rregullime duhen kryer nga tekniku specialist gjatë vënies në punë.

Të gjitha funksionet ose rregullimet mund të realizohen ose me një aplikacion Geberit, ose me Geberit Service-Handy. Rregullimet manuale përmes sensorit infrakuq nuk janë të mundura.

Rregullimet me Geberit Service-Handy

Me Geberit Service-Handy ofrohen funksionet dhe rregullimet e mëposhtme:

- Përdorimi:
 - Shpëlarja: Aktivizimi i një shpëlarjeje
 - Pastrimi: Ndalimi i aktivizimit të shpëlarjes për disa minuta
- Rregullimi i parametrave dhe funksioneve → shihni tabelën "Cilësimet"
- Tregimi i informacioneve të pajisjes, si për shembull kapaciteti i baterisë ose versioni i firmuerit → shihni tabelën "Informacionet"
- Tregimi i vlerave statistikore të përdorimit → shihni tabelën "Informacionet"

Në tabelën më poshtë, numrat dhe termat në kolonën "Pika e menysë" përkojnë me tregimin në ekranin e Geberit Service-Handy. Informacione të tjera për këtë gjenden në manualin e përdorimit të Geberit Service-Handy.

Tabela 1: Cilësimet

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi	Përdorimi	Shtrirja	Cilësimi nga fabrika
Komandat				
20 [Valve] [Ventil]	Aktivizimi i shpëlarjes Shkarkimi vazhdon për aq kohë derisa shkarkimi të ndalohej përsëri (maksimumi 10 min).	• Për testimin e funksionimit të elektrovalvulës • Për shpëlarjen e ujit të ndenjtur (në stanjacion) • Për dezinfektimin e tubave të linjës dhe rubinetit (> 3 min në > 70°C) • Për zbrazjen në dimër	Ndezur = <OK> Fikur = <OK>	Fikur
21 [RangeTest] [TestErfas]	Kontrolli i zonës së zbulimit Sapo një objekt të ndodhet në zonën e zbulimit, LED i kuq pulson. Shpëlarja nuk aktivizohet. Funkcioni çaktivizohet pas 90 s.	• Në problemet me identifikuesin e përdoruesit	Ndezur = <OK> Fikur = <OK>	Fikur

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi	Përdorimi	Shtrirja	Cilësimi nga fabrika
22 [ResetSens] [ResetSens]	Kalibrimi i sensorëve IR Sensorët IR kalibrohen nga e para. Udhëzim: Gjatë kalibrimit nuk duhet të ketë asnjë objekt ose dorë në lavaman.	- Në defektet e zbulimit - Në ndërrimin e ambientit (p.sh. lavaman i ri)	Nisja = <OK>	–
23 [FactorySet] [Werkseinst]	Cilësimet nga fabrika Të gjitha funksionet rikthehen në cilësimin e vendosur nga fabrika.	Për eliminimin e defekteve në funksionim	Nisja = <OK>	–
24 [CleanMode] [Pastrimi]	Aktivizimi i modalitetit të pastrimit Aktivizimi i shpëlarjes bllokohet për 10 minuta. Funksioni mund të ndalet përpara kohe nëpërmjet një lidhjeje të re me Geberit Service-Handy.	Për pastrimin e rubinetit dhe të lavamanit, pa rrjedhur ujë	Nisja = <OK> Ndalimi = <OK>	–
Programet				
30 [MainProgr] [Hauptmenü]	Modaliteti i funksionimit - Funksionim normal: Rubineti shkarkon ujë për aq kohë sa në zonën e zbulimit ndodhet një objekt. Në rast nevojë mund të vendoset një kohë e mbylljes me vonesë (pika 43 e menysë). - Kursim i ujit të pijshëm: Rubineti shkarkon ujë me kohë të kufizuar (pika 44 e menysë).	Për zvogëlimin e konsumit të ujit	[A] = Funksionim normal [B] = Kursim i ujit të pijshëm	Funksionim normal
31 [Esaver] [E Sparen]	Modaliteti i kursimit të energjisë Pas përfundimit të kohës së vendosjes (pika 40 e menysë) shpejtësia e reagimit të sensorit IR ngadalësohet. Koha e vendosjes fillon nga përdorimi i fundit.	Për zgjatjen e jetëgjatësisë së baterisë	Ndezur = [ON] Fikur = [OFF]	Fikur

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi	Përdorimi	Shtirirja	Cilësimi nga fabrika
34 [IntFlush] [IntervSp]	Shpëlarja me intervale - Komandim nga përdoruesi: Shpëlarja aktivizohet pasi [Intervali i shpëlarjes] përfundon (pika 42 e menysë), ku intervali i shpëlarjes fillon nga e para pas çdo përdorimi. Koha e shpëlarjes përcaktohet nëpërmjet vlerës [Spülzeit Intervallspülung (Koha e shpëlarjes e shpëlarjes me intervale)] (pika 41 e menysë). - Komandim nga intervali: Një shpëlarje aktivizohet pasi [Intervali i shpëlarjes] përfundon (pika 42 e menysë), pavarësisht nga përdorimet. Koha e shpëlarjes përcaktohet nëpërmjet vlerës [Spülzeit Intervallspülung (Koha e shpëlarjes e shpëlarjes me intervale)] (pika 41 e menysë).	- Për mbushjen e sifonit në rastin e përdorimit jo të shpeshtë - Për shkarkimin e ujit të ndenjur në tubacion (funksion higjienik, parandalimi i ndenjjes)	[0] = Fikur [1] = Komandim nga përdoruesi [2] = Komandim nga intervali	Komandim nga përdoruesi
Parametrat				
40 [ESaverT] [EnerSparZ]	Koha e vendosjes për kursimin e energjisë Nëse është aktivizuar modaliteti i kursimit të energjisë (pika 31 e menysë), pas përfundimit të kohës së vendosjes shpejtësia e reagimit të sensorit IR ngadalësohet.	Për zgjatjen e jetëgjatësisë së baterisë	6–48 h	6 h
41 [IntFlushT] [IntervSpZ]	Koha e shpëlarjes për shpëlarjen me intervale Është aktive kur pika e menysë 34 [Shpëlarja me intervale] është e vendosur te [1] ose [2].	–	1–200 s	5 s
42 [IntervalT] [IntervalZ]	Intervali i shpëlarjes për shpëlarjen me intervale Është aktive kur pika e menysë 34 [Shpëlarja me intervale] është e vendosur te [1] ose [2].	–	1–168 h	24 h
43 [RunOnTime] [NachlaufZ]	Koha e mbylljes me vonesë Në modalitetin e funksionimit Funksionim normal (pika 30 e menysë = [A]) rubineti vazhdon të shkarkojë ujë për kohën e mbylljes me vonesë, pasi objekti hiqet nga zona e zbulimit.	Për larjen e enëve	0–30 s	2 s

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi	Përdorimi	Shtirja	Cilësimi nga fabrika
44 [WSaverT] [TWSpaenZ]	Kohëzgjatja për kursimin e ujit të pijshëm Në modalitetin e funksionimit Kursim i ujit të pijshëm (pika 30 e menysë = [B]) rubineti shkar-kon ujë për aq kohë sa në zo-nën e zbulimit ndodhet një ob-jeht, por jo më gjatë se kohëz-gjatja për kursimin e ujit të pij-shëm.	- Për zvogëlimin e konsu-mit të ujit - Për marrjen e një sasive uji të caktuar	3–30 s	10 s
45 [DetectRng] [Erfassdis]	Rregullimi i distancës së zbulimit Distanca e zbulimit rregullohet në 5 nivele.	Për optimizimin e identi-fikimit të përdoruesit	0–4 [...] [0] = distancë e shkurtër [4] = distancë e madhe	Rubineti në mur: 4 Rubineti verti-kal: 3
46 [SensorUp] [SensOben]	Funksionimi i sensorit lart [Fikur]: Sensori IR i sipërm është i çaktivizuar. (Të dy se-sorët IR mund të çaktivizo-hen njëkohësisht.) [Statik]: Sensori IR reagon ndaj objekteve statike ose të lëvizshme. [Dinamik]: Sensori IR reagon vetëm ndaj objekteve të lëvi-zshme. [Automatik]: Sensori IR aktivi-zohet automatikisht në rast nevoje në modalitetin e për-shtatshëm.	Për përmirësimin e zbu-limit në rast ndikimesh interferuese të jashtme (p.sh. objekte me refle-ktim të fortë në dhomë)	[0] = Fikur [1] = Statik [2] = Dinamik [3] = Automatik	Automatik
47 [SensorLow] [SensUnten]	Funksionimi i sensorit posh-të [Fikur]: Sensori IR i poshtëm është i çaktivizuar. (Të dy se-sorët IR mund të çaktivizo-hen njëkohësisht.) [Statik]: Sensori IR reagon ndaj objekteve statike ose të lëvizshme. [Dinamik]: Sensori IR reagon vetëm ndaj objekteve të lëvi-zshme. [Automatik]: Sensori IR aktivi-zohet automatikisht në rast nevoje në modalitetin e për-shtatshëm.	Për përmirësimin e zbu-limit në rast ndikimesh interferuese të jashtme (p.sh. objekte me refle-ktim të fortë në dhomë)	[0] = Fikur [1] = Statik [2] = Dinamik [3] = Automatik	Automatik

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi	Përdorimi	Shtirirja	Cilësimi nga fabrika
48 [BasinDet] [BeckenDet]	Lavamani reflektues [Standard]: Sensorët IR identifikojnë objektet gjatë përdorimit të lavamanëve standarde prej qeramike. [Automatik]: Sensorët IR aktivizohen automatikisht në rast nevojë në modalitetin e përshtatshëm. [Reflektim i lartë]: Sensorët IR identifikojnë objektet gjatë përdorimit të lavamanëve me reflektim të lartë.	Për përmirësimin e zbulimit në lavamanët me reflektim të lartë (p.sh. lavamanët me shumë shkëlqim prej inoksi)	[0] = Standard [1] = Automatik [2] = Reflektim i lartë	Automatik

5 / 5

Tabela 2: Informacionet

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi
Numëruesit	
50 [Days?] [SumBetrT?]	Numri total i ditëve të punës Tregon numrin e ditëve të punës që nga vënia në punë.
51 [Uses?] [SumBenut?]	Numri total i përdorimeve Tregon numrin e përdorimeve që nga vënia në punë.
52 [IntFlush?] [SumIntSp?]	Numri total i shpëlarjeve me intervale Tregon numrin e shpëlarjeve me intervale që nga vënia në punë.
53 [↔ Days] [↔ SumBetrT]	Numri i ditëve të punës ndezur Tregon numrin e ditëve të punës që nga ndezja e fundit.
54 [↔ Uses] [↔ SumBenut]	Numri i përdorimeve ndezur Tregon numrin e përdorimeve që nga ndezja e fundit.
55 [↔ Flushes] [↔ SumSpül]	Numri i shpëlarjeve me intervale ndezur Tregon numrin e shpëlarjeve me intervale që nga ndezja e fundit.

Pika e menysë [EN] [DE]	Përshkrimi
Informacionet e pajisjes	
60 [TypeNoS] [TypeNoS]	Numri i artikullit i sensorit me rreze infra të kuqe Tregon numrin e artikullit të sensorit me rreze infra të kuqe. Shembull: [244617001] = 242.617.00.1
61 [TypeNoC] [TypeNoC]	Numri i artikullit i sistemit elektronik të komandimit Tregon numrin e artikullit të sistemit elektronik të komandimit. Shembull: [243689001] = 243.689.00.1
62 [SWVersion] [SWVersion]	Versioni i softuerit Tregon versionin e softuerit të sistemit elektronik të komandimit. Shembull: [0312] = Versioni 3.12
63 [SerialNoS] [SerialNoS]	Numri i serisë i sensorit me rreze infra të kuqe Tregon numrin e serisë së sensorit me rreze infra të kuqe. Shembull: 1234567
64 [SerialNoC] [SerialNoC]	Numri i serisë i sistemit elektronik të komandimit Tregon numrin e serisë së sistemit elektronik të komandimit. Shembull: SSVVXXXXXX
65 [ManufDatS] [ManufDatS]	Data e prodhimit e sensorit me rreze infra të kuqe Tregon datën e prodhimit të sensorit me rreze infra të kuqe. Shembull: 101220 = 10 dhjetor 2020
66 [ManufDatC] [ManufDatC]	Data e prodhimit e sistemit elektronik të komandimit Tregon datën e prodhimit të sistemit elektronik të komandimit. Shembull: 101220 = 10 dhjetor 2020
67 [TypePower] [Netz/Batt]	Mënyra e ushqimit elektrik Tregon mënyrën e ushqimit elektrik (rrjet elektrik ose bateri). Shembull: [0] = Bateri / [1] = Rrjet elektrik
68 [Battery%] [Batterie%]	Bateria Tregon kapacitetin e baterisë. Kur niveli shkon 10%, ndërroni baterinë ose karikoni akumulatorin. Shembull: [73] %

Rregullimet me aplikacionin Geberit

Pas lidhjes së një aplikacioni Geberit me pajisjen, ofrohen funksionet dhe rregullimet e mëposhtme:

- Përdorimi:
 - Shpëlarja: Aktivizimi i një shpëlarjeje
 - Pastrimi: Ndalimi i aktivizimit të shpëlarjes për disa minuta
- Rregullimi i parametrave dhe funksioneve → shihni tabelën "Cilësimet"
- Tregimi i informacioneve të pajisjes, si për shembull kapaciteti i baterisë ose versioni i firmuerit → shihni tabelën "Informacionet"
- Tregimi i vlerave statistikore të përdorimit → shihni tabelën "Informacionet"
- Eksporti i informacioneve të pajisjeve dhe vlerave statistikore
- Tregimi i mesazheve të gabimeve
- Ekzekutimet e përditësimit të firmuerit
- Ruajtja dhe transferimi i rregullimeve paraprahe

Cilësimet mund të ruhen në aplikacionin Geberit si rregullime paraprahe dhe të transferohen në pajisje të tjera.

Tabela 3: Cilësimet

Pika e menysë	Përshkrimi	Përdorimi	Shtrirja	Cilësimi nga fabrika
Përdorimi				
[Shpëlarja]	Aktivizimi i shpëlarjes Shkarkimi vazhdon për aq kohë derisa shkarkimi të ndalohe për-sëri (maksimumi 10 min).	• Për testimin e funksionimit të elektrovalvulës • Për shpëlarjen e ujit të ndenjur (në stanjacion) • Për dezinfektimin e tubave të linjës dhe rubinetit (> 3 min në > 70 °C) • Për zbrazjen në dimër	Ndezur/Fikur	–
[Pastrimi]	Aktivizimi i modalitetit të pastrimit Aktivizimi i shpëlarjes bllokohet për [kohën e pastrimit].	• Për pastrimin e rubinetit dhe të lavamanit, pa rrjedhur ujë	Ndezur/Fikur	–
	[Koha e pastrimit]	–	1–20 min	10 min

Pika e menysë	Përshkrimi	Përdorimi	Shtrirja	Cilësimi nga fabrika
Cilësimet e pajisjes				
[Shpëlarja me intervale]	Shpëlarja me intervale - Komandim nga përdoruesi: Shpëlarja aktivizohet pasi [interval i shpëlarjes] përfundon, ku intervali i shpëlarjes fillon nga e para pas çdo përdorimi. Koha e shpëlarjes përcaktohet nëpërmjet vlerës [Koha e shpëlarjes]. - Komandim nga intervali: Shpëlarja aktivizohet pasi [intervali i shpëlarjes] përfundon, pavarësisht nga përdorimet. Koha e shpëlarjes përcaktohet nëpërmjet vlerës [Koha e shpëlarjes]. - Shpëlarje e diferencës: Shpëlarja aktivizohet pasi [intervali i shpëlarjes] përfundon, pavarësisht nga përdorimet. Nëse brenda kohës së [intervalit të shpëlarjes] kryhen edhe shpëlarje të tjera, atëherë shpëlarja pasuese do të bëhet vetëm për diferencën e [kohës së shpëlarjes].	- Për mbushjen e sifonit në rastin e përdorimit jo të shpeshtë - Për shkarkimin e ujit të ndenjtur në tubacion (funksion higjienik, parandalimi i ndenjjes)	[Fikur], [Komandim nga përdoruesi], [Komandim nga intervali], [Shpëlarje e diferencës]	[Komandim nga përdoruesi]
	[Koha e shpëlarjes]	—	1–200 s	5 s
	[Intervali i shpëlarjes]	—	1–168 h	24 h
[Modaliteti i funksionimit]	Vendosja e modalitetit të funksionimit - Funksionim normal: Rubineti shkarkon ujë për aq kohë sa në zonën e zbulimit ndodhet një objekt. Në rast nevojë mund të vendoset një [kohë e mbylljes me vonesë]. - Kursim i ujit të pijshëm: Rubineti shkarkon ujë për aq kohë sa në zonën e zbulimit ndodhet një objekt, por jo më shumë se [Koha maks. e shkarkimit].	Për zvogëlimin e konsumit të ujit	[Funksionim normal] ose [Kursim i ujit të pijshëm]	[Funksionim normal]
	[Koha e mbylljes me vonesë]	—	0–30 s	2 s
	[Koha maks. e shkarkimit]	—	3–30 s	10 s

Pika e menysë	Përshkrimi	Përdorimi	Shtrirja	Cilësimi nga fabrika
[Zona e zbulimit]	Kontrolli i zonës së zbulimit Tregon se kur sensori identifikon një përdorim. Sensori mund të kalibrohet nga e para në rast të problemeve në zbulim apo në rast të ndërrimit të vendit. Për këtë duhet që ambienti të matet përsëri.	Në problemet me identifikuesin e përdoruesit	Automatik	—
	[Zona e zbulimit]	Për optimizimin e identifikimit të përdoruesit	Distanca e shkurtër deri në e gjatë [0–4]	Rubineti në mur: [4] Rubineti vertikal: [3]
	[Kalibro përsëri sensorin] Udhëzim: Gjatë kalibrimit nuk duhet të ketë asnjë objekt ose dorë në lavaman.	- Në defektet e zbulimit - Në ndërrimin e ambientit (p.sh. lavaman i ri)	[Nis kalibrimin]	—
[Funksionimi i sensorit lart]	Aktivizo funksionimin e sensorit lart [Fikur]: Sensori IR i sipërm është i çaktivizuar. (Të dy sensorët IR mund të çaktivizohen njëkohësisht.) [Statik]: Sensori IR reagon ndaj objekteve statike ose të lëvizshme. [Dinamik]: Sensori IR reagon vetëm ndaj objekteve të lëvizshme. [Automatik]: Sensori IR aktivizohet automatikisht në rast nevojë në modalitetin e përshtatshëm.	Për përmirësimin e sigurisë së zbulimit në rast ndikimesh interferuese të jashtme (p.sh. objekte me reflektim të fortë në dhomë)	[Fikur], [Statik], [Dinamik], [Automatik]	[Automatik]
[Funksionimi i sensorit poshtë]	Aktivizo funksionimin e sensorit poshtë [Fikur]: Sensori IR i poshtëm është i çaktivizuar. (Të dy sensorët IR mund të çaktivizohen njëkohësisht.) [Statik]: Sensori IR reagon ndaj objekteve statike ose të lëvizshme. [Dinamik]: Sensori IR reagon vetëm ndaj objekteve të lëvizshme. [Automatik]: Sensori IR aktivizohet automatikisht në rast nevojë në modalitetin e përshtatshëm.	Për përmirësimin e sigurisë së zbulimit në rast ndikimesh interferuese të jashtme (p.sh. objekte me reflektim të fortë në dhomë)	[Fikur], [Statik], [Dinamik], [Automatik]	[Automatik]

Pika e menysë	Përshkrimi	Përdorimi	Shtrirja	Cilësimi nga fabrika
[Reflektim]	Vendosja e modalitetit për lavamanët reflektues [Standard]: Sensorët IR identifikojnë objektet gjatë përdorimit të lavamanëve standardë prej qeramike. [Automatik]: Sensorët IR aktivizohen automatikisht në rast nevojë në modalitetin e përshtatshëm. [Reflektim i lartë]: Sensorët IR identifikojnë objektet gjatë përdorimit të lavamanëve me reflektim të lartë.	Për përmirësimin e zbulimit në lavamanët me reflektim të lartë (p.sh. lavamanët me shumë shkëlqim prej inoksi)	[Standard], [Automatik], [Reflektim i lartë]	Automatik
[Kursimi i energjisë]	Aktivizimi i modalitetit të kursimit të energjisë Pas përfundimit të [kohës së vendosjes] shpejtësia e reagimit të sensorit IR ngadalësohet. [Koha e vendosjes] fillon nga përdorimi i fundit.	Për zgjatjen e jetëgjatësisë së baterisë	Ndezur/Fikur	Fikur
	[Koha e vendosjes]	—	6–48 h	6 h
[Qarkullimi volumetrik]	Qarkullimi volumetrik Në mënyrë që të llogaritet konsumi i ujit, duhet që të specifikohet qarkullimi volumetrik i aktivizimit të shpëlarjes. Qarkullimi volumetrik përcaktohet nga rregullatori i rrjedhës. Nëse ndërrohet rregullatori i rrjedhës duhet përshtatur edhe qarkullimi volumetrik.	Për llogaritjen e konsumit të ujit për funksionin e statistikave	1,3 l/min 1,9 l/min 3,8 l/min 5 l/min 0,5–7 l/min (përcaktohet nga përdoruesit)	5 l/min
[Ruaj si rregullim paraprak]	Rregullimet paraprake Cilësimet aktuale ruhen në aplikacion dhe kështu që mund të transferohen në pajisje të tjera.	Për vënien në punë të disa pajisjeve me të njëjtat cilësime	—	—
[Cilësimet nga fabrika]	Cilësimet nga fabrika Të gjitha funksionet rikthehen në cilësimin e vendosur nga fabrika.	Për eliminimin e defekteve në funksionim	—	—

Tabela 4: Informacion

Pika e menysë së aplikacionit Geberit	Përshkrimi
[Emri] dhe [Fjalëkalimi]	Për çdo pajisje mund të vendosni një emër dhe një fjalëkalim.
Informacionet	
[Numri i artikullit i sensorit IR]	Tregon numrin e artikullit të sensorit IR.
[Numri i artikullit i sistemit elektronik të komandimit]	Tregon numrin e artikullit të sistemit elektronik të komandimit.
[Versioni i firmuerit]	Tregon versionin e firmuerit të sistemit elektronik të komandimit.
[Numri i serisë së sensorit IR]	Tregon numrin e serisë së sensorit IR.
[Numri i serisë së sistemit elektronik të komandimit]	Tregon numrin e serisë së sistemit elektronik të komandimit.
[Data e prodhimit e sensorit IR]	Tregon datën e prodhimit të sensorit IR.
[Data e prodhimit e sistemit elektronik të komandimit]	Tregon datën e prodhimit të sistemit elektronik të komandimit.
[Mënyra e ushqimit elektrik]	Tregon mënyrën e ushqimit elektrik (rrjet elektrik ose bateri).
Statistikat	
[Statistikat]	Tregon informacione të ndryshme, si për shembull numri i përdorimeve ose konsumi i ujit në një periudhë kohore të caktuar.
Numëruesit	
[Ditët e punës total]	Tregon numrin e ditëve të punës që nga vënia në punë.
[Ditët e punës nga ndezja e fundit]	Tregon numrin e ditëve të punës që nga ndezja e fundit.
[Përdorimet total]	Tregon numrin e përdorimeve që nga vënia në punë.
[Përdorimet nga ndezja e fundit]	Tregon numrin e përdorimeve që nga ndezja e fundit.
[Shpëlarjet total]	Tregon numrin e shkarkimeve/ shpëlarjeve që nga vënia në punë.
[Shpëlarjet nga ndezja e fundit]	Tregon numrin e shkarkimeve/ shpëlarjeve që nga ndezja e fundit.
[Shpëlarjet me intervale total]	Tregon numrin e shpëlarjeve me intervale që nga vënia në punë.
[Shpëlarjet me intervale nga ndezja e fundit]	Tregon numrin e shpëlarjeve me intervale që nga ndezja e fundit.

Përbërësit

Ky produkt është në përputhje me kërkesat e Direktivës 2011/65/EU (RoHS) (Për kufizimin e përdorimit të disa substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike).


Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike



Simboli i koshit mbi rrota mbi të cilin është vendosur një kryq do të thotë që pajisjet e vjetra elektrike dhe elektronike nuk lejohen të hidhen te mbetjet normale por duhet të trajtohen si mbetje të veçanta. Përdoruesit fundor janë të detyruar me ligj që për trajtimin e duhur ti kthejnë pajisjet te ofruesit e shërbimeve të trajtimit të mbetjeve, te shitësit ose te Geberit. Shumë shitës të pajisjeve elektrike dhe elektronike janë të detyruar të marrin në dorëzim falas pajisjet e vjetra elektrike dhe elektronike. Për të kryer kthimin te një Geberit duhet që të kontaktoni shoqërinë e shitjeve ose të ofruesit të shërbimeve.

Bateritë e vjetra dhe akumulatorët e vjetër, të cilët nuk janë të përfshirë nga pajisja e vjetër, si dhe llambat, të cilat mund të hiqen të padëmtuara nga pajisja e vjetër, duhet që të shkëputen nga pajisje e vjetër para se të bëhet dorëzimi të një qendër për grumbullimin e mbetjeve.


Nëse në pajisje janë ruajtur të dhëna personale, përdoruesit fundorë janë vetë përgjegjës që ti fshijnë ato para dorëzimit te një qendër për grumbullimin e mbetjeve.




→ **1 A**  45



→ **1 B**  46




→ **1 C**  46




→ **1 D**  47





1 A






1




2




1**B****1****2****1****C**

1**D****1****2****2****1**


2



3




4




3



1




2




3




4




4




→ **4 A** 50







→ **4 B** 50






→ **4 C** 51



→ **4 D** 51

4**A****1****2****4****B****1****2**

4**C****4****D****1****2**

Geberit International AG
Schachenstrasse 77, CH-8645 Jona
documentation@geberit.com
www.geberit.com

